

Data 13.02.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**Loti IV – “Blerje artikuj ushqimor kolonial (ambalazhuar/paketuar)” Marrëveshje
Kuahër me afat 12 Mujor - me një operatorë ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të
përcaktuara**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Loti IV – “Blerje artikuj ushqimor kolonial (ambalazhuar/paketuar)” - 15411110-6, 03221210-1, 15850000-1, 15332294-1, 15831000-2, 03211300-6, 15612100-2, 15612210-6, 15612220-9, 03212211-2, 03211600-9, 03211000-3, 15872400-5, 03212212-9, 15899000-6, 15332290-3.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi Limit total: Loti IV – “Blerje artikuj ushqimor kolonial (ambalazhuar/paketuar)” - me fond limit 55,218,381 (pesëdhjetë e pesë milion e dyqind e tetëmbëdhjetë mijë e treqind e tetëdhjetë e një) lekë pa T.V.SH ose 557,367.33 (pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë tridhjetë e tre) Euro.

KURSI KEMBIMIT 99.07 ALL/EURO, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë, datë 13.02.2025

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Loti IV: Blerje artikuj ushqimor kolonial (ambalazhuar/paketuar)

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e lotit (fondi limit i lotit).

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë

të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

- 2.2.1** Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasitë dhe llojin e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së se perlllogaritur te kontrates, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 40, pika 4e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogaritur te kontrates, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesmarres duhet të disponojë Certificate ISO 9001:2015 ose ekuivalente me të, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.

Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.

Argumentimi: *Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.,*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesmarres duhet të disponojë Certificate ISO 22000: 2018 ose ekuivalente me të, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.

Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtareve të BOE.

Argumentimi: *Paisja me këtë certifikatë ISO, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.*

2.3.4 OE ofertues duhet të paraqesë një vetdeklarim ku të deklarojë se ushtron aktivitetin e tij në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të depozitojë një nga dokumentat mëposhtme:

- ISO 14001: 2015 për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, ose ekuivalente;

ose

- Leje mjedisore sipas legjislacionit ne fuqi;

ose

- Cdo dokument tjetër ekuivalent, leshuar nga institucione te akredituara kombetare apo nderkombetare se ushtron aktivitetin e tij ne perputhje me legjislacionin mjedisor.

Dokumenti siperpemendur duhet te jete i vlefshem ne momentin e zhvillimit te procedures.

Argumentim: Kërkesa e AK për paraqitjen e vetdeklarimit për ushtrimin e aktivitetit në përputhje me legjislacionin mjedisor, si dhe depozitimi përpara publikimit të njoftimit të fituesit i një prej dokumentave provuese si ISO për sistemin e menaxhimit të mjedisit, apo leje mjedisore apo dokument tjetër të lëshuar nga insitucionet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit sipas legjislacionit mjedisor, është vendosur në zbatim të nenit 79 të LPP, nenit 40 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, si dhe Kriteve të përgjithshme të kualifikimit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 3 punonjës në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë listëpagesen e deklaruar përmes formës elektronike, ku te specifikohet numri i punonjesve.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e nevojave për furnizimin e vazhdueshëm, të përditshëm e të pandërprër të DPÇK me artikujt objekt prokurim. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 1 shoferë, 1 përfaqësues i autorizuar dhe 1 ekonomist.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 9 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti mallrash ATP, në pronësi ose ne perdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqes dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATP, te vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- certifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- certifikatë e kontrollit teknik
- certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton)

Përveç dokumentave të sipërpërmendura, në rastin kur mjeti është në perdorim sipas kontrates noteriale, OE duhet të paraqesë kontratën noteriale përkatëse, si dhe për mjetet

me kapacitet transportues mbi 1.5 ton, çertifikata e transportit të mallrave duhet të rezultojë për përdorim nga të tretët.

Argumentimi: Është kërkuar që OE të disponojë një automjet, i cili do të shërbejë për transportimin e mallrave në ambientet e DPÇK, në zbatim të kontratës objekt prokurimi. Për mjetet e transportit mbi 1.5 referuar ligjit nr. 8308 datë 18.03.1998 “për transportet rrugore”, i ndryshuar, nevojitet pajisja me çertifikatë transporti mallrash. Ndërsa referuar Njoftimit të APP nr. 4916/2 prot., datë 14.07.2022 çertifikata e transportit të mallrave për mjete të marra në përdorim duhet të jetë për përdorim nga të tretët.

2.3.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të lotit:

Për OE/BOE vendas:

Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Për OE/BOE e huaj:

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme për veprimtarinë e ushtruar sipas kërkesës së mësipërme, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës. Në këtë licencë duhet të jetë qartësisht e dallueshme veprimtaria përshkruese sipas këtij kriteri.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo është Licenca bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet përkatëse në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Për OE/BOE vendas:

Vetëdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

OE i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

Për OE/BOE e huaj:

Vetdeklarimi i paraqitur për plotësimin e këtij kriteri duhet të përshkruaj qartësisht:

- institucionin që ka ushtruar kontrollin përkatës në vendin e origjinës dhe website-in zyrtar të institucionit;
- datën e lëshimit të këtij dokumentacioni;

OE i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i institucionit përkatës në vendin e origjinës, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të institucionit përkatës në periudhën e vetdeklarimit.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

Argumentim: Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, “Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve”, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

2.3.9 OE duhet të paraqesë dëshmitë të testimeve zyrtare sipas kërkesave në specifikimet teknike, për secilin prej artikujve objekt i këtij loti.

Argumentim: Kjo kërkesë është vendosur me qëllim që OE të vërtetojë se artikujt e paraqitur si mostër plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe dëshmi të testimeve zyrtare të dorëzuara në SPE.

Mostrat e kërkuara do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK me adresë Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tirane.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë e cila të përmbajë elementet: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues.

Argumentim: Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 6/a.

2.3.11 Nëse Operatori Ekonomik oferton në më shumë se një lot, atëherë duhet të provojë se

disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar.

Argumentim: *Kërkesa që OE duhet të provojë se disponon kapacitetet financiare, ekonomike dhe teknike për realizimin e të gjitha loteve ku ka ofertuar është bazuar në nenin 42, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, gjithashtu kjo kërkesë i referohet rekomandimit të APP nr. 6732 prot., datë 21.10.2020, ku përcaktohet që nëse OE ofertojnë në më shumë se një lot, duhet ti provojnë AK se disponojnë aftësitë teknike dhe gjendjen ekonomike /financiare për realizimin e të gjitha objekteve të loteve ku kanë marrë pjesë nëse ato shpallen fitues.*

Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

○ Për hartimin e specifikimeve teknike është patur parasysh, natyra e përdorimit të produkteve ushqimore si produkte ushqimor në përbërje të menusë së miratuar me Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Hartimi i specifikimeve teknike, nga ana e Komisionit, është kryer duke iu referuar:

- “Katalogut të standarteve me objektin e prokurimit: “Blerje artikujsh ushqimorë”, miratuar nga Operatori i Blerjeve të Përqëndruara urdhër Nr.179, datë 08.11.2024, publikuar në faqen zyrtare të APP
- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, respektivisht për çdo artikull.
- Bazuar në Ligjin Nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi”, i ndryshuar.
- Ligjin Nr.10465, datë 29.09.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr.87/2012 për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.8.2012, të këshillit të ministrave “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.
- Bazuar në Ligjin Nr.87/2013, “Për kategorizimin e prodhimit, emërtimin dhe tregëtimin e vajit të ullirit dhe vajit të bërsisë së ullirit” dhe Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 235, datë 21.3.2017 Për miratimin e rregullores “Për karakteristikat e cilësisë dhe kriteret e natyrshmërisë së vajit të ullirit dhe vajit të bërsive të ullirit”.

➤ Udhëzimi Nr.2 datë 13.01.2021 “Për vendosjen e rregullave të hollësishme në lidhje me standardet e marketimit dhe tregtimit të vezëve”, në udhëzimin Nr.21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

➤ Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë Nr 15 dt. 09.09. 2021 “Mbi kritret mikrobiologjike për produktet ushqimore”.

➤ Ligji Nr.9942, datë 26.6.2008 “Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut” i ndryshuar.

➤ Vendimin Nr.434, datë 11.7.2018 “Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit”

➤ Udhëzimi Nr.207 datë 31.3.2015 “Për përcaktimin e treguesve të cilësisë dhe sigurisë së miellit të grurit të parapaketuar për t’u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore”.

Specifikimet teknike të përgjithshme të artikujve ushqimorë, kanë të përcaktuara karakteristikat, treguesit fiziko-kimikë dhe shqisorë, kërkesat cilësore, ambalazhimin dhe etiketimin e artikujve, kushtet e ruajtjes dhe transportit duke pasqyruar saktë dhe në mënyrë të plotë, kërkesat e Autoriteteve Kontraktore referuar gjendjes së tregut. Specifikimet teknike janë hartuar me qëllim që të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë Autoritetet Kontraktore dhe Operatorët Ekonomikë. Specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi.

➤ Gjithashtu, specialistë të DPÇK kanë realizuar takime dhe kanë qenë në bashkëpunim të përhershëm edhe me specialistë të “Sektorit të Ushqimit” në DPAKU, dhe ISUV, nga ku janë detajuar me korrektesë dhe profesionalizëm kërkesat ligjore për specifikimet teknike dhe kërkesat për sigurinë ushqimore të produkteve ushqimore.

Informacion argumentues për fondin limit:

Referuar Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për blerje "Artikuj Ushqimore kolonial (ambalazhuar/paketuar" për Çerdhet dhe Kopshtet e Tiranës për periudhën 12 mujore të Marrëveshje Kuadër.

Për vendosjen e çmimit Komisioni është bazuar në Proçes - Verbalin e Testimit të Tregut me çmimin mesatar të testimit të tregut.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.